

Roli dhe mundësitë e mediave serbe në Kosovë

2022



Roli dhe mundësitë e mediave serbe në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Roli dhe mundësitë e mediave serbe në Kosovë

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Për botuesin: Crno beli svet

Autori: Verka Jovanović & Snežana Djapić

Ky dokument fillimisht është shkruar në gjuhën serbe

Përktheu: Bruno Neziraj

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me Forumin për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik - FDMC. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it

Viti i botimit: 2022

PËRMBAJTJA

Rreth Nismës Open 07

Hyrje 08

01.

PËRMBLEDHJE
EKZEKUTIVE 09

02.

FUSHAX 10

2.1

PËRSHKRIMI I
GJENDJES DHE
DETEKTIMI I
PROBLEMIT 10

2.2

QËLLIMI I
STUDIMIT DHE
METODOLOGJIA E
HULUMTIMIT 12

2.3

REZULTATET E
HULUMTIMIT DHE
KONTEKSTUALIZIMI
I TYRE 14

Hulumtimi kualitativ 14

Hulumtimi kualitativ 21

Rreth Nismës Open

“Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - OPEN” është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Kjo nismë ka për synim të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

Organizatave të shoqërisë civile dhe mediat nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, në mënyrë specifike merren me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile dhe politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në hapjen e komunitetit serb në Kosovë. Përmes këtyre analizave vlerësohet se sa janë të hapura institucionet, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe vlerësohet shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë që të kuptohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përdorura në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj vendimmarrësve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Hyrje

Rreth studimit

Studimi ndjek trendët në punën e mediave të cilat raportojnë në gjuhën serbe në Kosovë: sa të lira janë për të kryer punën e tyre, nëse janë të hapura ndaj mendimeve dhe temave të ndryshme, sa mirë u përgjigjen nevojave të qytetarëve në punën e tyre, nëse përballen me censurë dhe auto censurë si dhe me sulme dhe presione. Në pjesën e parë të studimit është paraqitur një përshkrim i gjendjes në media, ba-

zuar në hulumtimin e këtij viti si dhe në hulumtimin e kryer nga CBS si pjesë e nismës OPEN në vitet 2020-2021 në partneritet me Qendrën Mediale nga Çagllavica. Pjesa e dytë e studimit i referohet gjetjeve kuantitative të hulumtimit të kryer si pjesë e nismës OPEN, ndërsa pjesa e tretë paraqet gjetjet kualitative të marra përmes intervistave të thelluara me gazetarët që raportojnë në gjuhën serbe në Kosovë. Në fund të analizës janë dhënë rekomandimet lidhur me mediat dhe institucionet.

01. Përmbledhja ekzekutive

Mediat që raportojnë në gjuhën serbe në Kosovë përballen me probleme dhe pengesa të shumta në kryerjen e detyrës së tyre për informim të drejtë dhe objektiv të qytetarëve. Dhe jo vetëm kaq, roli i medias është të nxisë pluralizmin e opinionit tek qytetarët, të sigurojë gjithëpërfshirjen e informacionit të rëndësishëm për funksionimin harmonik të shoqërisë, në varësi të temave për të cilat janë përcaktuar në statutin e tyre.

Me këtë hulumtim kemi dashur të zbulojmë sa janë në gjendje mediat të përmbushin rolin e tyre. Kemi zhvilluar një anketë në terren që ka përfshirë të anketuar nga veriu dhe jugu i Kosovës dhe kemi bërë intervista të thella me gazetarë nga komunitetet serbe në Kosovë.

Hulumtimi ka treguar se mediat, gjegjësisht gazetarët, si përfaqësues të mediave, i kuptojnë nevojat e qytetarëve për informim, por nuk janë në gjendje t'u përgjigjen atyre në mënyrë adekuate, për arsye të ndryshme. Disa nga arsyet janë si vijon:

- ⊖ Komunikimi i vështirësuar me institucionet
- ⊖ Censura dhe auto censura
- ⊖ Mungesa e kapaciteteve
- ⊖ Financimi

Nga ana tjetër, qytetarët e anketuar konsiderojnë se gazetarët shpesh nuk merren me tema të rëndësishme, kështu që 54% e të anketuarve besojnë se shpesh mungojnë lajmet e rëndësishme, ndërsa 55% të të anketuarve besojnë se gazetarët kanë frikë të thonë të vërtetën për

shkak të presioneve të ndryshme ndaj të cilave janë të ekspozuar.

Gazetarët që intervistuar e shohin ndryshe, duke theksuar se mungesa e kapaciteteve dhe personelit janë arsyeja kryesore pse ata nuk angazhohen në një masë më të madhe në punë hulumtuese.

Megjithatë, pajtohen se ka censurë, sidomos te mediat që financohen nga arka e shtetit, por edhe auto censurë, e cila është më e përhapur dhe ekziston në të gjitha mediat në Kosovë.

Rekomandimet kryesore

- ⊖ TË RAPORTOHET PËR TEMA LOKALE
- ⊖ TË EKSPLOROHEN NEVOJAT E AUDIENCËS
- ⊖ TË RAPORTOHET PËR PRESIONET DHE SULMET NDAJ GAZETARËVE
- ⊖ TË PËRGJIGJEN NË PYETJET E GAZETARËVE
- ⊖ TË REAGOHET NDAJ RASTEVE TE RAPORTUARA TE PRESIONIT DHE SULMEVE
- ⊖ TË SIGUROHEN FONDE TË QËNDRUESHME PËR FINANCIMIN E PUNËS SË MEDIAVE TË PAKICAVE
- ⊖ FONDET TË JU PËRSHTATEN NEVOJAVE TË MEDIAVE

02. Fusha X

2.1 Përshkrimi i gjendjes dhe detektimi i problemit

⊖ Cila është gjendja në fushën me të cilën merreni?

Mediat në Kosovë ballafaqohen me probleme të shumta në punën e tyre, siç tregojnë raportimet e shumta për këtë fushë. Mungesa e zbatimit të garancive ligjore për punonjësit e medias dhe mbrojtja institucionale e gazetarëve, mosrespektimi i ligjit për qasje në informata, refuzimi i institucioneve dhe përfaqësuesve të tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, burimet e kufizuara financiare dhe rrjedhimisht mungesa e kapaciteteve për të kryer punën e gazetarisë - janë vetëm disa nga problemet me të cilat ballafaqohen gazetarët në Kosovë. Përveç këtyre, mediat që raportojnë në gjuhën serbe ballafaqohen edhe me problemin e mosrespektimit të ligjit për gjuhët zyrtare, kështu që shpeshherë ndodh që kur marrin përgjigje nga institucionet, përgjigja është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo në serbisht, që po ashtu është gjuhë zyrtare në Kosovë. Në intervistat me studiuesit e CBS, gazetarët deklaruan se mediat në gjuhën serbe përballen me presione në punën e tyre, si dhe censurë dhe auto censurë.

Gjithsej 48 media janë aktive në gjuhën serbe, nga të cilat 8 janë televizione, 21 radio stacione dhe 13 portale online dhe 6 video produksione. Një pjesë e mediave bashkëpunojnë përmes 3 rrjeteve, rrjetit Kosma, rrjetit Most dhe rrjetit të TV të pavarura.

48 media janë aktive në gjuhën serbe



8 televizione



21 radio stacione



13 portale online



6 video produksione

Hulumtimi i kryer nga Crno Beli svet dhe Qendra Mediale nga Çagllavica gjatë viteve 2020-2021 në kuadër të nismës OPEN tregoi se ekzistojnë disa burime të informacionit në zonat në të cilat jetojnë serbët në Kosovë. Qytetarët kanë qasje në përmbajtjen mediatike nga mediat nga Kosova që raportojnë në gjuhën serbe, mediat shqiptare nga Kosova, si dhe mediat nga Serbia. Në këtë situatë, mediat serbe nga Kosova nuk janë në pozitë të barabartë për nga kapaciteti i produksionit për sa i përket llojit si dhe sasisë së përmbajtjes që prodhojnë në baza ditore.

Mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën serbe në shumicën e rasteve janë të regjistruara në Komisionin e Pavarur për Media sipas Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe mund të ndahen në:

- Mediat e themeluara nga shteti (ndërmarrje publike ose transmetues publik)
- Mediat komerciale (të krijuara si një iniciativë ndërmarrëse e pronarëve të tyre)
- Mediat që funksionojnë si organizata joqeveritare të regjistruara
- Korrespondentë ose zyra të mediave ose agjencive selia e të cilëve është në Beograd ose jashtë
- Produksionet lokale audio-video që transmetojnë programin e tyre të prodhuar nëpërmjet mediave partnere dhe nëpërmjet internetit.

Kosova qendrore dhe veriu i Kosovës kanë mbulim më të mirë medial, ndërsa mbulimi më i keq është në Dukagjin, Gorë (ku jetojnë goranët dhe boshnjakët që flasin gjuhën serbe dhe boshnjake) dhe Komuna e Zubin Potokut në veri të Kosovës. Njëjtë mund të vlerësohet edhe puna e mediave në terren. Më së shumti raportohet nga Kosova qendrore dhe veriore, si dhe nga Anamorava, ndërsa më së paku nga Zhupa e Siriniqit, Dukagjini, Gora dhe Komuna e Zubin Potokut.

Sipas metodave të financimit, mediat serbe ndahen në ato që financohen nga:

- Ndarjet e planifikuara financiare nga buxheti i Serbisë (NP Mreža Most)
- Mjetet e ndara nga Ministria e Kulturës dhe Informimit e Republikës së Serbisë në bazë të Konkursit për bashkëfinancim të mediave elektronike
- Mjetet që ndahen në bazë të konkursit nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Kabinetin e Kryeministrit të Kosovës
- Ndarjet e planifikuara financiare nga buxheti i Kuvendit të Kosovës (RTK2)
- Donacionet nga organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja në bazë të projekteve (donatorët më të mëdhenj për

media në gjuhën serbe deri më tani kanë qenë: OSBE, UNDP, USAID, NED, BTD, KFOS dhe ambasadat e: Norvegjisë, SHBA-ve, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, etj.)

- Sponsorizimet (minimale dhe të papërfillshme)
- Të ardhurat nga reklammat (minimale dhe të papërfillshme)

a. Çfarë ndryshimesh po ndodhin, cilat janë tendencat

Hulumtimi i këtij viti tregon se mediat kanë gjithnjë e më shumë probleme në përpjekje për të ardhur tek informacioni dhe bashkëbiseduesit, si në institucione ashtu edhe në mesin e qytetarëve. Disa pjesëmarrës të hulumtimit theksojnë se ka media që janë në "listën e zezë" të zyrtarëve serbë nga Kosova dhe se përveçse nuk u përgjigjen pyetjeve të tyre, nuk ftohen në konferencat zyrtare për media.

Gazetarët e intervistuar theksojnë se mediat e pavarura janë në një pozitë gjithnjë e më të vështirë për shkak të financimit të paqëndrueshëm dhe mos qasjes të informacioni dhe zyrtarët. Lidhja me donatorët dhe financimi në bazë të projekteve po ashtu vështirëson punën e tyre sepse nuk ka financim afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Nga ana tjetër, janë të detyruar t'i përshtatin projekt propozimet e tyre me qëllimet e donatorëve, ndaj shpeshherë detyrohen të kryejnë edhe punë të tjera, si organizimi i tryezave të rrumbullakëta, fokus grupeve, anketave, gjë që u lë më pak kohë për punë gazetareske. Në të njëjtën kohë, puna në projekte kërkon edhe një pjesë administrative të punës të cilën pastaj detyrohen ta bëjnë vet gazetarët sepse zakonisht fjala është për redaksi të vogla. Kjo e bën të vështirë për ta që të kushtojnë më shumë për kohë disa tema më të ndërlikuara dhe raportimi i tyre shpesh reduktohet në përcjelljen e deklaratave dhe njoftimeve.

b. Cilët janë hisedarët e rëndësishëm dhe cilat janë rolet e tyre

Rolin më të rëndësishëm në sigurimin e pluralizmit në raportim e luan Komisioni i Pavarur për Media (KPM). KPM-ja është organi kryesor rregullator i pavarur që "licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale". Vërejtjet për punën e këtij organi i referohen thjeshtësisë së procedurës dhe kërkesave minimale për regjistrimin e mediave, përzgjedhjen e anëtarëve të BD nga Kuvendi i Kosovës, si dhe vonesat në iniciimin e rasteve dhe shqiptimin e gjobave për shkelje të ligjit. Në kompetencë të këtij organi janë edhe radio stacionet dhe televizionet. Këshilli i mediave të shkruara është përgjegjës për respektimin e kodit të mediave të shkruara dhe standardeve të gazetarisë në mediat e shkruara, si dhe në portalet e internetit. Ligji rregullon edhe ekzistencën e Shërbimit Transmetues Publik (SHTP) ose RTK-së, si transmetues publik.

c. Cilat janë problemet kryesore?

Hulumtimi *A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë*¹ nga viti 2021 ka treguar praninë e një polarizimi të theksuar në mesin e mediave serbe në Kosovë, i cila është i lidhur me ndarjen në burimet e përmendura të financimit.

Po ashtu, problemet kryesore të mediave serbe në Kosovë kanë të bëjnë me mjetet buxhetore. Financimi përmendet si element kyç, i cili prek të gjitha segmentet e punës së mediave, duke filluar nga zgjedhja e temave deri te burimet e informacionit dhe qasjes tek hisedarët kryesorë politikë të rëndësishëm për raportim.²

1 A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë, OPEN 2021, <https://kfos.org/al/publikime/99/otvorenost-srpskih-medija-na-kosovu>

2 A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë, OPEN 2021, <https://kfos.org/al/publikime/99/otvorenost-srpskih-medija-na-kosovu>



Gazetarët e intervistuar theksojnë se mediat e pavarura janë në një pozitë gjithnjë e më të vështirë për shkak të financimit të paqëndrueshëm dhe mos qasjes të informacioni dhe zyrtarët. Lidhja me donatorët dhe financimi në bazë të projekteve po ashtu vështirëson punën e tyre sepse nuk ka financim afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Nga ana tjetër, janë të detyruar t'i përshtatin projekt propozimet e tyre me qëllimet e donatorëve, ndaj shpeshherë detyrohen të kryejnë edhe punë të tjera, si organizimi i tryezave të rumbullakëta, fokus grupeve, anketave, gjë që u lë më pak kohë për punë gazetareske.

Një tjetër tendencë problematike në fushën e mediave është dominimi i politikës. Temat politike mbisundojnë në të gjitha sferat e jetës së qytetarëve, gjë që reflektohet edhe në punën e mediave, të cilat kanë pak hapësirë për të raportuar për tema të tjera. Problemi i tretë lidhet me sigurinë e gazetarëve. Gazetarët përballen me kërcënime dhe presione, ndërkohë që mungon mbrojtja institucionale dhe zgjidhja në kohë e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve.

2.2 Qëllimi i studimit dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi kryesor i studimit është të kontribuojë në zhvillimin e pluralizmit në komunitetet serbe në Kosovë përmes analizës së lirisë së mediave në gjuhën serbe në Kosovë dhe analizës së ndikimit të mediave në krijimin e opinionit publik dhe mundësimin e zgjedhjes së informuar nga ana e qytetarëve.

Do të përpiqemi të zbulojmë si ndikojnë tendencat ekzistuese në hapjen e mediave për t'iu përgjigjur nevojave mediale të qytetarëve dhe për të siguruar përfaqësimin e pluralizmit të opinionëve të qytetarëve në sferën publike.

Pyetjet të cilave do të përpiqemi t'i përgjigjemi në këtë hulumtim janë si vijon:

- ⊖ Deri në çfarë mase i kuptojnë mediat nevojat e qytetarëve për informim dhe a i përgjigjen në mënyrë adekuate këtyre nevojave?
- ⊖ A pengon pasiguria e gazetarëve të mediave serbe në Kosovë gazetarët të merren me tema dhe probleme të caktuara?
- ⊖ Në çfarë mase institucionet dhe partitë politike sigurojnë të dhënat e nevojshme/kërkuara për mediat?

Synimet e studimit:

- 1 Të hulumtohet nëse dhe në çfarë mase ka auto censurë në mediat serbe në Kosovë përmes intervistave me gazetarët
- 2 Të ndikohet në pluralizmin e opinionit përmes teksteve dhe formave të ndryshme të informimit të qytetarëve përmes teksteve, qëndrimeve dhe opinionëve të ndryshme autoriale.
- 3 Vlerësimi i aftësisë së mediave që, duke marrë parasysh specifikat e mjedisit në të cilin punojnë, të informojnë qytetarët në mënyrë të tillë që të kenë mundësi të marrin vendime të informuara për aspekte të rëndësishme të jetës.
- 4 Të kontribuohet në kuptim më të mirë të nevojave të qytetarëve për informim dhe prishmëritë e tyre nga media

Për arritjen e synimeve të studimit janë realizuar hulumtimi kuantitativ dhe kualitativ.

Si pjesë e hulumtimit kuantitativ është kryer një anketë në terren në jug dhe veri të Kosovës. Janë



Rolin më të rëndësishëm në sigurimin e pluralizmit në raportim e luan Komisioni i Pavarur për Media (KPM). KPM-ja është organi kryesor rregullator i pavarur që “licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale”. Vërejtjet për punën e këtij organi i referohen thjeshtësisë së procedurës dhe kërkesave minimale për regjistrimin e mediave, përzgjedhjen e anëtarëve të BD nga Kuvendi i Kosovës, si dhe vonesat në iniciimin e rasteve dhe shqiptimin e gjobave për shkelje të ligjit.

anketuar gjithsej 600 persona, nga të cilët 300 ishin në veri, në komunat e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, dhe 300 në jug (nga rajoni i Graçanicës, Anamoravës, Shtërpcës dhe Gorazhdecit).

Si pjesë e hulumtimit kualitativ, janë kryer pesë intervista të thelluara me gazetarë nga veriu dhe jugu i Kosovës. Në bisedë me ta jemi përpjekur të kuptojmë si ata zgjedhin temat dhe nëse përballen me presion për të punuar ose për të mos punuar në tema të caktuara, pastaj nëse mediat në gjuhën serbe në Kosovë kontribuojnë në pluralizmin e opinionit të qytetarëve përmes temave që trajtojnë, nëse ka censurë dhe auto censurë dhe cila është situata në lidhje me qasjen në informata nga institucionet qendrore dhe vendore.

2.3 Rezultatet e hulumtimit dhe kontekstualizimi i tyre

Hulumtimi kualitativ

Përmes anketave në terren, qytetarët e kombësisë serbe janë përgjigjur në pyetjet si i shohin mediat në mjedisin e tyre dhe nëse mediat u

përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të tyre. Fillimisht, kemi pyetur qytetarët sa kanë besim në mediat që i përkasin grupeve dhe rajoneve të ndryshme gjuhësore. Sipas rezultateve, mediat serbe nga Beogradi dhe Kosova gëzojnë besimin më të madh të qytetarëve (rreth 80% e të anketuarve kanë deklaruar se plotësisht ose më së shumti u besojnë këtyre mediave).



Mirëpo, kur bëhet fjalë për besimin tek mediat shqiptare në Kosovë dhe të huajat, situata është krejtësisht ndryshe. Rreth 81% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk u besojnë aspak ose nuk kanë besim në mediat shqiptare në Kosovë. Po ashtu, 12% kanë deklaruar se kanë besim në këto media dhe 7% nuk e kanë ditur ose nuk kanë dashur të përgjigjen.


Kur bëhet fjalë për mediat e huaja, besimi i qytetarëve është pak më i lartë se në mediat shqiptare, por dukshëm më i vogël se besimi në mediat serbe. 24% e të anketuarve nga Kosova u besojnë këtyre mediave, ndërsa besimi kryesisht ose plotësisht mungon tek 65% të të anketuarve.




Është e mundur që një nga arsyet e mosbesimit në media nga një përqindje e caktuar e qytetarëve të rrjedhë nga besimi se mediat janë nën kontrollin e qeverisë dhe partive politike. 61% e të anketuarve pajtohen me këtë pohim, 12% e të anketuarve besojnë se mediat nuk janë nën kontrollin e qeverisë dhe partive politike, ndërsa 26% e të anketuarve nuk kanë ditur të përgjigjen ose ishin të pavendosur lidhur me këtë.

Shumica e të anketuarve (58%) gjithashtu konsiderojnë se mediat janë të njëanshme dhe favorizojnë një anë të caktuar, ndërsa 17% mendojnë ndryshe. Megjithatë, është interesante të theksohet se 40% e të anketuarve deklaruan se mediat përpiqen ta përpunojnë storjen në mënyrë kritike dhe nga disa këndvështrime (grafiku 7).


05. Mediat janë në kontrollin e partive politike dhe pushtetit



06. Konsideroj që informatat që marr nga mediat janë të anshme, dhe favorizojnë një palë të caktuar




07. Kur raportojnë për ngjarje, mediat mundohen të përpunojnë storien në mënyrë kritike dhe nga disa kande



Në bazë të përgjigjeve të qytetarëve, mund të konstatojmë se ndonëse shumica prej tyre mendojnë se mediat janë të njëanshme, ata megjithatë mendojnë se mediat mundohen të përpunojnë në mënyrë kritike storjen nga disa këndvështrime. Shkakun e kësaj kontradik-

te mund ta gjejmë në përgjigjet në pyetjet e mëposhtme. Gjegjësisht, 55% e të anketuarve mendojnë se gazetarët kanë frikë të thonë të vërtetën për shkak të presioneve të ndryshme ndaj të cilëve janë të ekspozuar, ndërsa 18% e të anketuarve mendojnë se kjo nuk është e vërtetë.

08. Mendoj se gazetarët frikohen të shkruajnë / tregojnë të vërtetën për shkak të presioneve të ndryshme ndaj të cilëve janë të ekspozuar




Tutje, 40% e të anketuarve besojnë se mediat nuk janë të pavarura dhe se nuk marrin vet vendime për mënyrën e raportimit, ndërsa 32% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë deklaratë, domethënë besojnë se mediat janë të pavarura. Është interesante e dhëna se mesatarisht 20% e të anketuarve iu përgjigjën pyetjeve rreth pavarësisë së mediave me "as pajtohem e as nuk pajtohem". Kjo është një përqindje mjaft e lartë e


atyre që janë indiferentë ndaj pretendimeve që kërkojnë një qasje kritike dhe ndërgjegjësimit për punën e mediave në mjedisin e tyre.

50% e të anketuarve besojnë se ka dallim në raportim dhe punë profesionale tek mediat e ndryshme në Kosovë, ndërsa 19% besojnë se kjo nuk është e vërtetë.

09. Besoj se mediat janë të pavarura dhe vet marrin vendime si do të raportojnë




10. Ekziston dallimi në raportim dhe punë profesionale në mesin e mediave në Kosovë



Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e temave në media, tema që u interesojnë qytetarëve, 54% e të anketuarve besojnë se shpesh mungojnë

lajmet e rëndësishme, ndërsa 24% besojnë të kundërtën.

11. Shpesh vërej që disa lajme të caktuara mungojnë në media



Për pyetjen "Propozoni 3-5 tema që mediat serbe në Kosovë do të duhej të trajtonin më shpesh" ishte lejuar mundësia për të dhënë më shumë përgjigje. Prandaj kemi të paraqitura tema të shumta të cilat qytetarët i kanë veçuar si të rëndësishme dhe të cilat nuk janë të përfaqësuara sa duhet në hapësirën mediale. Temat që kanë marrë më së shumti nominime

janë kultura/arti, pastaj ekonomia, sporti, arsimit, siguria dhe papunësia, respektivisht punësimi, me këtë renditje. Këto tema kanë marrë mbi 100 vota të qytetarëve. Tema të tjera që ishin nominuar ishin turizmi, argëtimi, ekologjia, dhuna ndaj grave, shëndetësia e të tjera. Në grafikun më poshtë është paraqitur një përmbledhje e detajuar me numrat e votave.

E gjetura më interesante është se numri më i madh i përgjigjeve ishte "Nuk e di". Këtë mund ta interpretojmë në disa mënyra:

- ⊖ qytetarët janë pasivë dhe të pa interesuar
- ⊖ mungon pluralizmi i opinionit tek qytetarët
- ⊖ qytetarët nuk shohin mundësi reale për të ndikuar në temat të cilat mediat i shtjellojnë.

Natyrisht, arsyet janë të ndryshme dhe supozimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht gjendjen faktike. Megjithatë, është fakt që shumica e qytetarëve nuk dinin t'i propozonin temat për të cilat do të dëshironin të lexonin apo dëgjonin në media, gjë që sigurisht është shqetësuese dhe sinjalizon indiferencën e qytetarëve ndaj punës së mediave.

Hulumtimi kualitativ

Për qëllime të hulumtimit kualitativ, janë realizuar 5 intervista me gazetarët serb nga Kosova. Jemi përpjekur të kuptojmë sa i plotësojnë mediat nevojat e qytetarëve për sa i përket përfaqësimit të temave që janë të rëndësishme për qytetarët, në aspektin objektiv, por edhe në aspektin e aftësisë së medias për të informuar qytetarët në atë mënyrë që ata të kenë mundësi të marrin vendime të informuara për aspekte të rëndësishme të jetës.

Të gjithë gazetarët e intervistuar theksuan se në media mbizotërojnë temat informative që kanë të bëjnë me politikën, madje edhe politikën e lartë, më shumë se temat lokale. Po ashtu, theksojnë se mungon një punë serioze hulumtuese, pasi, siç thonë ata, mediave lokale i mungojnë kapacitetet për këtë.

Pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen mediat në Kosovë në punën e tyre janë:

- ⊖ Mungesa e komunikimit me institucionet – lokale dhe qendrore
- ⊖ Censura dhe auto censura
- ⊖ Mungesa e kapaciteteve
- ⊖ Financimi




Të gjithë gazetarët e intervistuar theksuan se në media mbizotërojnë temat informative që kanë të bëjnë me politikën, madje edhe politikën e lartë, më shumë se temat lokale. Po ashtu, theksojnë se mungon një punë serioze hulumtuese, pasi, siç thonë ata, mediave lokale i mungojnë kapacitetet për këtë.

Komunikimi i vështirësuar me institucionet

Si një nga pengesat më të mëdha në punën e mediave dhe zbatimin e detyrës së tyre për të nxitur pluralizmin e opinionit tek qytetarët dhe për t'iu përgjigjur nevojave mediale të qytetarëve përmendet mungesa e komunikimit me institucionet dhe për rrjedhojë vështirësitë në marrjen e informatave me rëndësi për publikun.

"Njerëzit që punojnë në ato institucione nuk e kuptojnë se puna e tyre është që të na japin informacione, e për më tepër mediat i perceptojnë ose si armik ose si subjekt opozitar që bën gjithçka për t'i kundërshtuar dhe për të transmetuar në publik ato që bëjnë keq... Në vend që t'i shohin mediat si një lloj mbështetjeje për të përmirësuar punën e tyre dhe për të promovuar atë që bëjnë", thotë një gazetar nga veriu i Kosovës.

Mungesa e komunikimit është e pranishme si në mesin e përfaqësuesve të institucioneve në nivel lokal dhe atyre në nivel qendror, duke përfshirë Kabinetin e Kryeministrit, ministrinë dhe qeverinë e Kosovës, dhe siç thotë një gazetar: "Situata më e rëndë është me përfaqësuesit e Listës Serbe", të cilët rrallë përgjigjen në pyetjet e gazetarëve. Një gazetar thekson se Lista Serbe rrallë u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve dhe kur ndodh, kjo bëhet me shkrim, "sikur kanë frikë nga mundësia që t'u bëhet ndonjë pyetje tjetër".



Ato presione padyshim që ekzistojnë, unë jam përballur me një nga ato...Mendoj se disa media dhe gazetarë edhe vet tashmë e dinë se çfarë duhet të raportojnë dhe se për shkak të disa strukturave politike nuk mund të shkruajnë për ndonjë çështje. Tashme ekziston një shabllon për atë që mund dhe nuk mund të shkruhet. Mendoj se ekziston në disa media”.

Gazetarët edhe me tutje theksojnë se situata është edhe më e rëndë kur bëhet fjalë për përfaqësuesit e autoriteteve të kombësisë shqiptare, me të cilët nuk ka fare komunikim dhe se më parë gjendja ka qenë më e mirë, para ardhjes së kryeministrit Kurti në pushtet:

“Vetëm nëse mbahet ndonjë konferencë për media na ofrohet mundësia t'i bëjmë pyetje Kurtit, Vjosa Osmanit apo ndonjë zyrtari tjetër. Ata sillen plotësisht në mënyrë injorante ndaj gjithë komunitetit serb, e njëjtë edhe ndaj mediave. Kurti që kur ka ardhur në pushtet nuk ka dhënë asnjë deklaratë apo intervistë ekskluzive për asnjë televizion, radio apo media serbe”.

Censura dhe auto censura

Gazetarët e intervistuar në përgjithësi pajtohen se ka edhe censurë edhe auto censurë në mediat serbe në Kosovë, por ata në përgjithësi nuk e shohin veten si subjekt të saj.

“Ato presione padyshim që ekzistojnë, unë jam përballur me një nga ato...Mendoj se disa media dhe gazetarë edhe vet tashmë e dinë se çfarë duhet të raportojnë dhe se për shkak të disa

strukturave politike nuk mund të shkruajnë për ndonjë çështje. Tashme ekziston një shabllon për atë që mund dhe nuk mund të shkruhet. Mendoj se ekziston në disa media”.


Siç shpjegon një gazetarë, përpjekjet për censurë ndodhin në një mënyrë mjaft delikate dhe jo aq haptazi. Prandaj beson se ka më shumë auto censurë sesa censurë:

“Kam pasur një situatë me një kolege nga një redaksi tjetër që haptazi më ka thirr. Fillimisht nisi me një shaka se nuk duhet ta publikoja atë, sepse, ja, është budallallëk, është budallallëk përgjigja që kemi marrë nga një përfaqësues i një institucioni. Kur e kuptoi që kisha ndërmend ta publikoja, më thirri sërish dhe e përsëriste të njëjtin tregim se është budallallëk çdo gjë që na ishte thënë në deklaratë dhe se nuk do të duhej ta publikonim dhe vazhdonte të përsëriste të njëjtin mesazh. Epo, ky padyshim ishte një tentim për të më bërë presion”.

Si një temë tjetër e nxehtë e që konsiderohet e ndaluar janë financat, “ku shkojnë paratë”, respektivisht shkrimi për tenderët dhe zbatuesit e projekteve që kanë marrë para nga fondi shtetëror apo ndërkombëtar, por nuk kanë çuar projektin deri në fund.

Më tej theksohet se mediat lokale mund të shkruajnë për “mashtime të vogla dhe krime të vogla”, ndërsa për diçka më të madhe ose nuk janë në gjendje për shkak të gjendjes financiare dhe mungesës së kapaciteteve ose thjesht kanë frikë nga pasojat.

Siç sqarojnë gazetarët, temat e korrupsionit dhe krimin të madh janë tema që kërkojnë guxim dhe etikë gazetarë, por edhe bashkëbisedues, të cilat është vështirë të gjenden në komunitetet e vogla ku njerëzit kanë frikë të flasin për gjëra të tilla, qoftë publikisht apo në mënyrë anonime. Shumë shpesh heqin dorë nga storja për shkak të mungesës së bashkëbiseduesve, të cilët janë të rëndësishëm për vërtetimin e fakteve.



Kam pasur një situatë me një kolege nga një redaksi tjetër që haptazi më ka thirr. Fillimisht nisi me një shaka se nuk duhet ta publikoja atë, sepse, ja, është budallallëk, është budallallëk përgjigja që kemi marrë nga një përfaqësues i një institucioni. Kur e kuptoi që kisha ndërmend ta publikoja, më thirri sërish dhe e përsëriste të njëjtin tregim se është budallallëk çdo gjë që na ishte thënë në deklaratë dhe se nuk do të duhej ta publikonim dhe vazhdonte të përsëriste të njëjtin mesazh. Epo, ky padyshim ishte një tentim për të më bërë presion”.

Siç thonë ata, me punë më të thella hulumtuese merren mediat rajonale, siç është BIRN-i, apo mediat hulumtuese nga Beogradi. Gazetarët nga mjediset serbe në Kosovë thonë se bashkëbiseduesit preferojnë t’u përgjigjen mediave që vijnë nga jashtë dhe mediave që perceptohen si media rajonale dhe “të mëdha”.

Nga ana tjetër, nuk mungojnë edhe kritikant për mediat lokale se shpeshherë ata zgjedhin bashkëbiseduesit mbi baza nëse ata iu përshtaten në rrafshin privat apo jo: “Ndodh që njerëzit të cilët mediat e Beogradit i perceptojnë si bashkëbisedues, ne të mos i perceptojmë si bashkëbisedues. Për shkak se i njohim nga qyteti dhe nga disa ngjarje të tjera, për neve ata nuk janë bashkëbisedues shumë të mirë. Kjo është e gabuar sepse, nëse ai ka informacione që paraqet publikisht dhe është në interes të publikut të di për atë informacion, nuk ka më lidhje çfarë është ai person privatisht”.

Mungesa e kapaciteteve

Mungesa e kapaciteteve, pra stafit, përmendet si arsyeja kryesore pse mediat në gjuhën serbe në Kosovë nuk angazhohen ose angazhohen shumë pak në punë hulumtuese. Gjithashtu, disa gazetarë deklaruan se shtëpitë mediale nuk kanë kapacitet për të mbuluar madje as ngjarjet lokale sepse këto ngjarje kërkojnë dalje në terren dhe ndarje të punëve, të cilat nuk mund t’i kryejnë për shkak të numrit të vogël të punëtorëve. Mungesa e kapaciteteve është e lidhur ngushtë me financimin, por edhe me ikjen e trurit. Siç thekson një gazetar, “Të rinjtë e kanë të vështirë të vendosin nëse do të qëndrojnë në gazetari. Zakonisht kjo zgjat disa muaj. Mundësia e parë që u ofrohet për të bërë diçka tjetër, ata e kapin atë dhe bëjnë.”

Financimi

Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen mediat dhe që pengon mediat të ju përgjigjen plotësisht nevojave të qytetarëve është financimi. Mediat kanë nevojë për mbështetje afatgjatë, sistematike për punën e tyre, “për prodhimin e përmbajtjes dhe jo për debate, diskutime dhe lloje të tjera aktiviteteve publike”.

Siç theksojnë gazetarët, nuk ka asnjë mënyrë për vetëqendrueshmëri të mediave përmes shërbimeve mediale dhe gjithnjë e më shumë po tentojnë të bëhen organizata joqeveritare për t’u financuar nga buxhetet për projekte.

4. Rekomandimet

Rekomandimet për mediat

TË RAPORTOHET PËR TEMA LOKALE

Hulumtimi i këtij viti konfirmon trendin e krijuar gjatë viteve 2020-2021 se mediave në gjuhën serbe në Kosovë u mungojnë më shumë storjet gazetare lidhur me çështjet lokale. Arsyet për këtë janë redaksitë e vogla, fakti që qytetarët hezitojnë të flasin publikisht, por edhe që institucionet lokale nuk u përgjigjen pyetjeve të gazetarëve. Është e nevojshme të gjenden mënyra për t'i bërë temat lokale më të dukshme në hapësirën publike, madje edhe në mënyra të tjera kreative, jo domosdoshmërisht përmes një storje klasike gazetareske (foto reportazh për një problem apo temë lokale në ueb faqen ose rrjetin social të medias, video, anketë me telefon ose online në lidhje me ndotjen, furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimit, çmimet e artikujve ose tema të tjera lokale.)

TË EKSPLOROHEN NEVOJAT E AUDIENCËS

Mediat në gjuhën serbe në Kosovë janë më së shumti të përqendruara në tema politike, dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe ngjarjet tjera aktuale politike ditore. Për shkak të mungesës së kapaciteteve, shpesh nuk janë në gjendje të merren me tema si kultura, sporti, arti, ekonomia dhe me tema të tjera që janë në interes të publikut dhe qytetarëve. Prandaj, është e nevojshme të bëhen sondazhe periodike të opinionit publik dhe audiencës së synuar për të përshtatur raportimin e tyre me nevojat e qytetarëve.

TË RAPORTOHET PËR PRESIONET DHE SULMET NDAJ GAZETARËVE

Të gjithë gazetarët e intervistuar janë përballur me një lloj presioni gjatë punës së tyre, por jo të gjithë janë sa duhet aktiv në raportimin e kësaj dukurie. Vetë gazetarët duhet të jenë më aktiv në raportimin e çdo lloj presioni (drejtpërdrejt apo online) me të cilin ballafaqohen, qoftë nga redaktorët, përfaqësuesit e qeverisë apo qytetarët. Ndodh që gazetarët të mos i marrin seriozisht komentet apo mesazhet që ju vijnë drejtpërdrejt apo përmes rrjeteve sociale, andaj për ta bërë këtë duhet të inkurajohen nga shoqatat e gazetarëve, organizatat ndërkombëtare apo vendase që merren me lirinë e medias.

Rekomandimet për institucionet

TË PËRGJIGJEN NË PYETJET E GAZETARËVE

Pamundësimi i qasjes në dokumente publike dhe përgjigjet e vonuara të institucioneve dhe pushtetit lokal për media paraqesin një tjetër trend që përsëritet vit pas viti. Marrja e përgjigjeve brenda afateve të përcaktuara me ligj, marrja e përgjigjeve për pyetjet specifike dhe mundësia për të marrë përgjigje në gjuhën serbe ende paraqesin vështirësi me të cilat ballafaqohen gazetarët në punën e tyre të përditshme. Ky trend duhet ndryshuar dhe të punësuarit nëpër institucione dhe përfaqësuesit politikë duhet të jenë koshient ndaj interesave të publikut.

TË ZGJIDHEN ME KOHË RASTET E RAPORTUARA TË PRESIONIT DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE


Presionet ndaj gazetarëve si dhe shënjestrimi i gazetarëve dhe mediave janë të papranueshme, qofshin ato nga individët, politikanët apo përfaqësuesit e qeverisë. Është e domosdoshme të krijohet një mjedis i sigurt për punën e gazetarëve, andaj është e rëndësishme që rastet e raportuara të sulmeve dhe presioneve ndaj gazetarëve të zgjidhen në kohën e duhur për të treguar një shembull të praktikës së mirë, por edhe për të shërbyer si paralajmërim për ata që potencialisht mund të ushtrojnë presion mbi gazetarët.

TË SIGUROHEN FONDE TË QËNDRUESHME PËR FINANCIMIN E PUNËS SË MEDIAVE TË PAKICAVE

Po ashtu, është e nevojshme të vendosen procedura të qarta për ndarjen e mjeteve, që paraqet një mekanizëm të besueshëm për mbështetjen e punës së mediave. Është e nevojshme të sigurohet transparenca e të gjithë procesit të ndarjes së mjeteve.

FONDET TË JU PËRSHTATEN NEVOJAVE TË MEDIAVE

Përfaqësuesit e mediave theksojnë gjithnjë e më shumë se një nga problemet me të cilat përballen është se donatorët nuk e njohin përmbajtjen mediale si aktivitet të projektit dhe se gazetarët shpesh detyrohen të kryejnë detyra që janë tipike për organizatat joqeveritare. Prandaj, është e nevojshme që donatorët të mbështesin më shumë lirinë e shprehjes dhe raportimin objektiv gazetar, respektivisht t'i përshtatin thirrjet për projekt propozime me aktivitetin bazë të medias.



Të gjithë gazetarët e intervistuar janë përballur me një lloj presioni gjatë punës së tyre, por jo të gjithë janë sa duhet aktiv në raportimin e kësaj dukurie. Vetë gazetarët duhet të jenë më aktiv në raportimin e çdo lloj presioni (drejtpërdrejt apo online) me të cilin ballafaqohen, qoftë nga redaktorët, përfaqësuesit e qeverisë apo qytetarët.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

